



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:157321

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05467990

C.nr.925/21

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Izet Gërguri, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve N.B dhe A.M të cilet sipas autorizimit i përfaqëson av.F.B nga Vushtrria kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë, për kompensimin e pagës së fundvitit, jashtë seance, me datën 18.03.2024 e mori dhe e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M
(pa shqyrtim gjyqësor)

APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësve N.B dhe A.M për kompensimin e pagave të fundvitit 2018, 2019 dhe 2020 ashtu që DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, që:

- a) paditësit N.B, në emër të kompensimit të pagave të fundvitit, (në vlerë të një page mujore prej 619.86 euro), për vitet 2018, 2019 dhe 2020, **të ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1859,58 euro dhe**
- b) paditësit A.M në emër të kompensimit të pagave të fundvitit, (në vlerë të një page mujore prej 575,01 euro), për vitet 2018, 2019 dhe 2020, **të ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1725,03 euro**, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 15.07.2021 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 177 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësit, përmes të autorizuares të tyre të cekur në hyrje të këtij aktgjykimi, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi ndaj të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, për kompensimin e pagave të fundvitit për periudhën kohore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke theksuar se të lartcekurat janë në marrëdhënie të rregullt të punës tek e paditura dhe në bazë të nenit 29 par.5 të Udhëzimit Administrativ mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës numër 02/2018 i datës 14.11.018, u takon edhe nga një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, mirëpo e paditura për këto shpërblime për vitet 2018, 2019 dhe 2020, nuk ua ka paguar paditësve.

Andaj, paditësit kanë paraqitur padi me të cilën kanë kërkuar që tu kompensohet paga e 13-të për vitet 2018, 2019 dhe 2020, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E autorizuar e paditësit me parashtrësën e ka precizuar kërkesëpadinë, ashtu që ka heqë dorë nga kërkesa për shpërblimi jubilar duke kërkuar që paditësit të kompensohen nga një pagë për fundvitet 2018, 2019, 2020 për secilin vit shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale dhe atë për përpilim padie 156 euro, për parashtrësë për precizim padie 156 dhe taksë gjyqësore të paguar 21 euro.

E paditura në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, me të cilën ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar. Sa i përket kompensimit të pagës së 13-të, e

ka kundërshtuar pasi që nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare, duke arsyetuar se Ministria e Financave nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë e kësaj çdo veprim apo nismë, duke përfshirë edhe nenin 29 pika 2 të Ua numër 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Ka kërkuar nga gjykata që padia e paditësit të refuzohet e pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpafia e paditësit është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga vërtetimi i lëshuar nga Policia e Kosovës vërtetohet se paditësi N.B i punësuar pranë të paditues nga data 24.09.2001 dhe realizon të ardhura mujore prej nga 619,86 euro për vitet 2018, 2019 dhe 2020 e gjithashtu paditësi A.M është i punësuar pranë të paditues nga data 21.08.2000 dhe realizon të ardhura mujore prej nga 575.01 euro për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

Nga Formularet e vlerësimeve të rezultateve në punë të nëpunësve për vitin 2018, 2019 dhe 2020 vërtetohet fakti se paditësit në këto tri vite janë vlerësuar me vlerësim të kënaqshëm (3+) dhe nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës për këtë periudhë kohore.

Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Sa i përket kërkesës lidhur me kompensimin pagës së trembëdhjetë, gjykata gjen se në rastin konkret duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës (tutje: UA nr.02/2018) i cili ka hy në fuqi me datë 18.11.2018, andaj me kujdes analizoi dispozitën e nenit 29 paragrafin 2 të këtij UA, ku është përcaktuar se “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”.

Gjykata në këtë çështje kontestimore ka vërtetuar faktin se paditëset kanë pasur vlerësim të kënaqshëm të performancës gjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020 dhe të njëjtit në këtë periudhë kohore nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, fakt i vërtetuar përmes formularëve të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve që gjenden në shkresat e lëndës.

Për më tepër e paditura me anë të përgjigjes në padi nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje që do të vinte në dyshim performancën e paditësit për vitet e lartcekura, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj paditësit.

Nga dispozita e lartcekur, rrjedh edhe e drejta e paditësit dhe detyrimi i të paditurës, që pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në këtë dispozitë në fund të një viti kalendarik, paditësi të përfitojë si shpërblim një pagë mujore e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, andaj gjykata pasi vërtetoi edhe lartësinë e pagës mujore të paditësve përmes Vërtetimeve të punësimit të lëshuara nga Policia e Kosoves me të dhëna si në shkresat e lëndës, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së ku parashihet që “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese

gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Pretendimin e të paditurës dhënë në përgjigje në padi se nuk ka mjete financiare për kompensimin e këtij shpërblimi, gjykata i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme dhe i vlerëson si të parëndësishme për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike kontestuese, pasi që paditësi nuk është përgjegjës për planifikimin e buxhetit për obligimet që dalin nga UA nr.02/2018, andaj edhe rrethanat subjektive të të paditurës lidhur me mos planifikimin me kohë të buxhetit për zbatimin e këtij udhëzimi administrativ nuk e liron të njëjtën nga detyrimi për pagesën e këtyre shpenzimeve.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë sipas mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës të vitit 2020.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën I të dispozitivit, gjykata e morri sipas nenit 452 par.2 të LPK-së, duke pasur parasysh suksesin në procedurë, me ç’rast paditësve iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 156 € dhe atë për përpilimin e padisë ndërsa 21 euro për taksë për padi, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17), ndërsa nuk ia njohu shpenzimet për precizim të kërkesëpadisë në lartësi prej 156 euro pasi që pala paditëse e ka pasur për detyrim që ta precizoj dhe kjarhtësoj kërkesën e tij që me rastin e dorëzimit të kërkesës së tij-tyre.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.925/21, datë: 18.03.2024

Gj y q t a r i:
Izet Gërguri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.